

Luan TETAJ

**THEMELIMI I KAZERMËS "JUSUF GËRVALLA"
NË PRAPAQAN DHE SITUATA NË DUKAGJIN MË 1998**

Abstrakt:

Kazerma "Jusuf Gërvalla", e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e themeluar në vitin 1998 në Prapaqan, në Komunën e Deçanit, ka luajtur rol të rëndësishëm në sensibilizimin, organizimin dhe përgatitjen e ushtarëve të UÇK-së. Kazerma është emërtuar me këtë emër për nder të heroit të Kosovës Jusuf Gërvalla, figurë e rëndësishme e çështjes kombëtare shqiptare në Kosovë. Kazerma shërbeu si qendër për stërvitjen e ushtarëve të UÇK-së dhe organizimin e operacioneve të ndryshme ushtarake në Zonën Operative të Dukagjinit. Themelimi i Kazermës së Ushtrisë Çlirimtare "Jusuf Gërvalla", gjatë asaj kohe ishte një hap i rëndësishëm në sensibilizimin e luftës çlirimtare jo vetëm në komunën e Deçanit, por edhe më gjerë. Pas funksionalizimit të kazermës ushtarake, shumë të rinj u trajnuar në mënyrë profesionale rreth përdorimit të armeve, sepse pjesa më e madhe e tyre nuk kishin njohuri dhe mësimi për përdorimin e armëve ishte thelbësor për ushtarët e rinj të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Fjalë kyçe: Zona Operative, Dukagjini, lufta, UÇK, Kazerma "Jusuf Gërvalla", Shtabi i Përgjithshëm, Ministria e Mbrojtjes, Prapaqani.

Rrethanat e përgjithshme politike në Kosovë në vitin 1998 ishin të vështira për organizimin e Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe për fillimin e luftës së armatosur kundër Serbisë. Mirëpo, në kushtet e pushtimit të rëndë serb, ishte jo vetëm nevojë, por e domosdoshme organizimi dhe fillimi i luftës së armatosur për çlirimin e Kosovës. Në Rrafshin e Dukagjinit merita të mëdha në organizimin dhe fillimin e luftës së armatosur të UÇK-së, pa dyshim ka familja Haradinaj e Gllogjanit. Pas luftës në Prekaz dhe qëndresës heroike të Adem Jasharit, forcat policore dhe ushtarake serbe e sulmuan Gllogjanin më 24 mars 1998. Luftimet qenë shumë të ashpra. Gllogjani u mbrojt nga pjesëtarët e UÇK-së, të udhëhequr nga Ramush Haradinaj. Beteja

u zhvillua deri në orët e vona të mbrëmjes.¹ Gjatë luftimeve ranë dëshmorë Himë Haradinaj, Gazmend dhe Agron Mehmetaj. Njësitet policore dhe ushtarake serbe u tërhoqën me humbje. Sulmi në Gllogjan dhe qëndresa heroike e njësiteve të UÇK-së bëri jehonë të madhe në Rrafshin e Dukagjinit.² Pas sulmit në Gllogjan, grupe të njerëzve në mënyrë vullnetare filluan të organizohen pothuajse nëpër të gjitha fshatrat e komunës së Deçanit, të Pejës, të Gjakovës etj.

Vullneti për t'u bashkëngjitur njësiteve të UÇK-së ishte i jashtëzakonshëm, por mundësitë ishin shumë të vogla, sepse mungonte armatimi. Kjo nuk e ndali mobilizimin e fshatrave të komunës së Deçanit dhe më gjerë për t'u mobilizuar dhe armatosur sa më parë, sepse lufta tashmë kishte shpërthyer në gjithë territorin e komunës së Deçanit. Pak kohë pas sulmit të 24 marsit, u formua shtabi në Gllogjan, i cili u shndërrua si pikë reference në Zonën e Dukagjinit, ku shumë të rinj merrnin rrugën drejt Shqipërisë për t'u furnizuar me armë. Nuk kishte armatim të mjaftueshëm të siguruar nga përgjegjësit e UÇK-së në Shqipëri, por falë mobilizimit të diasporës arritën të mbledhin të holla për blerjen e armëve në Shqipëri, si: pushkë, automatikë, mortajë, predha kundërtanke, pushkë snajper, municion, bomba dore, granatahedhës etj. Masivizimi i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Rrafshin e Dukagjinit dhe veçanërisht në komunën e Deçanit u bë edhe më i madh në muajt maj-qershor të vitit 1998. Gjatë kësaj kohe furnizimi me armatim bëhej me shumë vështirësi nga Shqipëria. Sipas një raporti të Brigadës së Motorizuar 549 të ushtrisë jugosllave të datës 5 mars 1998 përshkruhen “rrugët kryesore” të UÇK-së për futjen e fshehtë të armatimit në Kosovë: rruga “Bajram Curri”, Junik, rruga “Liqeni” dhe rruga “Qafa e Dobrunës” në drejtim të Rogovës, pika kufitare Stojanoviq dhe Mandiq dhe Lugina e Plavës.³ Përveç këtyre rrugëve kishte edhe rrugë tjera alternative për futjen e armëve në Kosovë. Nga Zona e Dukagjinit armatimi shpërndahej edhe në zonat tjera të Kosovës.

Organizimi dhe armatosja e fshatrave në mënyrë vullnetare nuk ishte e lehtë për t'u bërë, sepse mungonte gjithçka përveç dëshirës për t'u

¹ *Fjalori Enciklopedik i Kosovës, I, A-K*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Prishtinë, 2018, 176; Luan Tetaj, “Themelimi i Kazermës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Baran 1998” (Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare, “Jasharajt dhe lufta çlirimtare”, organizuar me rastin e vitit jubilar, 20-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Prishtinë, më 6 mars 2018), Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë, 375.

² Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë (1998-1999) I*, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2010, 141; *Fjalori Enciklopedik i Kosovës, I...*, 596.

³ Kombet e Bashkuara, Lënda nr. IT-04-84bis-T, data: 29 nëntor 2012, Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë prej vitit 1991, 12, 17.

mobilizuar sa më parë. Fshatrat në bazë të përvojës dhe njohurive profesionale e zgjidhnin “komandantin e fshatit” për të pasur organizim sa më të lehtë të luftës. Nga fundi i muajit maj 1998, pothuajse të gjitha fshatrat në komunën e Deçanit dhe më gjerë krijuan udhëheqësinë e tyre ushtarake duke organizuar stërvitje ushtarake për përdorimin e armëve, sepse pothuajse e gjithë rinia e asaj kohe nuk kishte njohuri për përdornin e armëve. Të gjitha fshatrat ishin të rrethuara nga forcat e policisë dhe të ushtrisë serbe.

Organizimi i fshatrave ishte i domosdoshëm, sepse ishte mënyra e vetme për t’u mbrojtur dhe për t’i rezistuar forcave serbe të armatosura rënd dhe njërive të motorizuara policore dhe ushtarake serbe. Me angazhimin e fshatrave për luftë të armatosur ishte shtuar nevoja për një organizim ushtarak më të mirë. Në bazë të analizës së gjendjes në terren u diskutua mundësia rreth komandës së njësuar në Zonën e Dukagjinit. Si rrjedhojë e gjendjes në terren më 26 maj 1998, në Glllogjan u mbajt mbledhja për caktimin e nënzonave dhe formimin e Shtabit rajonal.⁴ Mbledhjen e kryesoi z. Ramush Haradinaj, kurse të pranishëm në mbledhje ishin rreth 80 përfaqësues të zgjedhur nga fshatrat e tyre. U diskutua mundësia për t’u organizuar sa më mirë që ishte e mundur, sepse vetëm të mirorganizuar dhe të bashkuar mund t’u rezistonin me sukses forcave serbe dhe ta çonin deri në fund luftën për çlirimin e Kosovës. Në mbledhje të gjithë përfaqësuesit e fshatrave me konsensus të plotë morën vendim për themelimin e pesë nënzonave në Rrafshin e Dukagjinit.

I. “Nënzona e parë” me bazë në Gjlllogjan, në komunën e Deçanit e komanduar nga Ramush Haradinaj, e cila përfshinte fshatrat: Glllogjan, Shaptej, Gramaqel, Dubravë, Baballoq, Prilep dhe Rastavica. **II. “Nënzona e dytë”** me bazë në Irzniq, në komunën e Deçanit e komanduar nga Shemsedin Çekaj, e cila përfshinte fshatrat: Irzniq, Ratishë e Epërme, Ratishë e Ulët, Beleg dhe Kodrali. **III. “Nënzona e tretë”** me bazë në Pozharë, në komunën e Deçanit e komanduar nga Rustem Tetaj, e cila përfshinte fshatrat: Llukë e Epërme, Llukë e Ulët, Lumbardh, Dashinoc, Maznik dhe Vranoc. **IV. “Nënzona e katër”** përfshinte zonën që ndahej nga lumi Bistricë dhe fshati Isniq në komunën e Deçanit. Komandohej nga Skënder Rexhahmetaj, e cila përfshinte fshatrat: Prapaqan, Strelle i Epërm, Strelle i Ulët, Dubovikë, Kryshec dhe Raushiq. **V. “Nënzona e pestë”**, komandohej nga Adem Ukëhaxhaj në komunën e Deçanit, që përfshinte fshatrat: Carrabreg, Voksh dhe Dranoc.⁵

⁴ Organizimi i një takimi të tillë u bë për herë të parë deri në atë kohë për të diskutuar rreth organizimit më të mirë të luftës në rajonin e Rrafshit të Dukagjinit.

⁵ Deklaratë e eprorit Skënder Rexhahmetaj, datë 1 korrik 2011 (Dorëshkrim); Deklaratë e oficerit Rustem Tetaj dhënë autorit më 17 korrik 2003; Ismet Haskaj, *Deçani gjatë luftës*

Fshatrat e Rekës së Keqe nuk ishin të përfshira në këto pesë zona, pasi ato konsideroheshin si një zonë e veçantë, e cila shërbente për furnizimin e zonave të tjera. Ajo ishte një nga zonat më të organizuara, ngaqë ndodhej në brezin kufitar me Shqipërinë dhe ofronte mundësi më të mëdha për t'u armatosur.⁶

Lufta sa vinte dhe bëhej më e ashpër në terren dhe në një mënyrë apo tjetër e impononte riorganizim e strukturave të UÇK-së në Rrafshin e Dukagjinit. Organizimi u bë për arsye praktike dhe profesionale për t'i koordinuar sa më mirë veprimet në terren. Mbledhja e parë e nënzoneve të Zonës së Dukagjinit dhe Jabllanicës u mbajtë në Irzniq, në komunën e Deçanit, më 21 qershor 1998. Arsye e kësaj mbledhjeje ishte përmirësimi dhe koordinimi i veprimeve të përbashkëta. Ndërsa, më 23 qershor 1998 në Jabllanicë u mbajt një mbledhje në të cilën morën pjesë pjesëtarët e UÇK-së, si: Ramush Haradinaj, Shemsedin Çekaj, Salih Veseli, Rustem Tetaj, Skënder Rexhahmetaj, Lahi Brahimag, Nazmi Brahimag, Daut Haradinaj, Alush Agushi, Emrush Xhemajli, Faton Mehmetaj, Ali Avdiu-Gramaçeli, Agron Januzi, Mustafë Zeqa dhe Rexhep Selimi në cilësinë e përfaqësuesit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Arsyeja e mbledhjes ishte përmirësimi dhe organizimi i luftës dhe formimi i një komande të njësuar, krijimi i Shtabit Operativ të Dukagjinit dhe emërimi i komandantit të Zonës Operative të Dukagjinit. Të gjithë përfaqësuesit e nënzoneve u pajtuan të rekrutoheshin si anëtarë të Zonës Operative të Dukagjinit.

Pas diskutimeve të gjata të gjithë pjesëmarrësit iu nënshtruan votimit dhe me shumicë votash u zgjodh Ramush Haradinaj-komandant i Zonës Operative të Dukagjinit, Lahi Brahimag-zëvendëskomandant, Salih Veseli u emërua shef i Shtabit (zëvendëskomandant i operacioneve), Rustem Tetaj u emërua zëvendësshef i Shtabit (zëvendëskomandant i operacioneve), Idriz Balaj (toger) u caktua përgjegjës për operacione kundërterroriste dhe sabotim (ndihmës për operacione sabotimi) dhe Faton Mehmetaj u caktua përgjegjës për Shërbimin e Zbulimit (Shërbimin Informativ).⁷ Vendimet e dala nga kjo mbledhje u miratuan edhe nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Po ashtu në këtë mbledhje me vendim unanim të pranishmit vendosen për krijimin e "Shtabit Operativ të Zonës Operative të Dukagjinit" me qendër në Gllogjan. Anëtarët e Shtabit Operativ të Zonës Operative të Dukagjinit ishin Ramush Haradinaj, Rustem Tetaj, Skënder Rexhahmetaj, Gani Xhukaj dhe Shemsedin Çekaj. Anëtarët e Shtabit Operativ të Zonës Operative të

çlirimtare 1998-1999, Monografi, Lidhja e Historianëve të Kosovës "Ali Hadri", Prishtinë, 106; Kombet e Bashkuara, Lënda nr. IT-04-84bis-T, data: 29 nëntor 2012..., 23.

⁶ Deklaratë e oficerit Rustem Tetaj dhënë autorit më 4 dhjetor korrik 2004.

⁷ Kombet e Bashkuara, Lënda nr. IT-04-84bis-T, data: 29 nëntor 2012..., 31-32.

Dukagjinit mblidheshin një herë ose dy herë në javë sipas nevojës së luftimeve në terren për të diskutuar rreth mbrojtjes dhe sigurisë së popullatës. Takimet zakonisht mbaheshin në Gllogjan, Irzniq, Pozharë, Kodrali, Isniq dhe Llukë e Ulët.⁸

Masivizimi i luftës dhe rritja në vazhdimësi e numrit të të rinjve të rekrutuar në radhët e UÇK-së, shtoj nevojën e formimit të një qendre më të madhe ushtarake, në përgatitjen e kuadrit të UÇK-së për luftë. Ndër personat e parë që u angazhuan dhe dhanë kontribut të madh në krijimin e kazermës ushtarake, ishin: Ramush Haradinaj, Rustem Tetaj, Skënder Rexhahmetaj, Gani Xhukaj, Shemsedin Çekaj dhe Sali Veselaj, i cili erdhi më vonë dhe dha një kontribut të çmuar me përvojën e tij ushtarake.⁹ Pas një analize të gjithanshme këta ekspertë ushtarakë morën vendim që kazerma të ngrihet në lokalet e shkollës fillore në fshatin Prapaqan.¹⁰ Për marrjen e këtij vendimi, patën parasysh shumë faktorë. Në radhë të parë fshati Prapaqan ishte në mes të fshatrave dhe ishte pikë e rëndësishme strategjike ku forcat ushtarake e policore serbe më vështirësi të madhe mund të depërtonin deri në brendësi të fshatit.

Me qëllim të rritjes së gatishmërisë luftarake, përgatitjen e kuadrove cilësore, komandimit dhe udhëheqjes së njësisë të Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit, si dhe plotësimit të formacioneve ushtarake të UÇK-së, meqë rrethanat luftarake ishin të favorshme në atë kohë në Dukagjin, Komandanti i SHORD mori vendim për themelimin e “Qendrës për përgatitjen e luftëtarëve dhe eprorëve të UÇK-së, e cila u emërua Jusuf Gërvala”¹¹ - Kazerma e Prapaqanit. Kryeshef i Qendrës është emëruar eprori Rustem Tetaj, përgjegjës për procesin edukativo-mësimor eprori eprori Driton Zeneli (tani Hero i Kosovës) dhe përgjegjës për logjistikë eprori Naim Maloku.¹²

⁸ *Po aty.*

⁹ Bardh Hamzaj, *Rrëfimi për luftën dhe lirinë (Dialog me komandantin Ramush Haradinaj)*, “Dukagjini”, Pejë, 2001, 82.

¹⁰ Fshati Prapaqan shtrihet rreth 4km në verilindje të komunës së Deçanit. Për herë të parë përmendet në dokumentet e shkruara në krisobulën e Manastirit të Deçanit në vitin 1330 me emrin Praprajah. Prapranjani gjatë asaj kohe mendohej se i kishte rreth 52 shtëpi. Në defterin e regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1885, përmendet me emrin Papragjani, varet nga Peja dhe kishte rreth 19 shtëpi.

¹¹ Pas vrasjes së Jusuf Gërvallës, në vitin 1982, ai u bë një simbol i qëndresës dhe i sakrificës për lirinë e Kosovës. Për këtë arsye, emri i tij është përdorur për të nderuar kujtimin e njërit prej figurave më të rëndësishme të kësaj periudhe, që dha jetën për çlirimin e Kosovës nga okupimi serb. Emërimi i kazermës me emrin e tij është një shenjë e përjetësisë së kontributit të tij dhe të angazhimit të pandalshëm për lirinë e Kosovës.

¹² Shtabit Operativ i Rrafshit të Dukagjinit- Urdhëresë për përgatitjen ushtarake të ushtarëve dhe eprorëve, N/O/D-14/05.

Për arsye të rrethanave shumë të vështira të luftës dhe në mungesë të kushteve teknike, vendimi është shkruar më vonë më datën 8 korrik 1998. Vendimi përmbante:

1. *Në Prapaqan të hapet qendra për përgatitjen e luftëtarëve dhe eprorëve për nevojat e luftës çlirimtare.*
2. *Qendra të emërtohej me emrin e heroit të kombit, Jusuf Gërvalla.*
3. *Për kryeshef të qendrës emërtoi eprorin, Rustem Tetaj.*
4. *Përgjegjës për procesin edukativ-mësimor e emëroi eprorin, Driton Zeneli.*
5. *Të gjithë komandantët e njërive të SHORRD janë të obliguar t'i caktojnë luftëtarët më të dalluar në përgatitjen luftarake si dhe cilësitë tjera morale-kombëtare, njëkohësisht komandantët kanë përgjegjësinë për të ndihmuar në realizimin e procesit mësimor sipas planit dhe programit të hartuar nga komanda e SHORRD.*
6. *Për nevojat e logjistikës së qendrës së lartpërmendur e emëroi përgjegjës NKL (nënkolonel) epror, Naim Malokun.¹³*

Vendimi për themelimin e Kazermës së UÇK-së “Jusuf Gërvalla” në Prapaqan, ishte arritje e madhe për të ngritur sa më lart nivelin e organizimit dhe profesionalizmin e UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit. Ky vendim u prit jashtëzakonisht mirë te masat e gjëra të popullsisë në komunën e Deçanit dhe më gjerë, sepse krijoi një frymë të paparë deri në atë kohë ku shumë të rinj dhe të reja shprehen interesim për t’u bashkëngjitur radhëve të njësiteve të UÇK-së. Formimi i Kazermës së UÇK-së ishte unik për kohën dhe ishte njëra ndër të parat e llojit të saj në territorin e Kosovës. Funksionalizimi i Kazermës ishte shumë sfidues për kryeshefin e saj z. Rustem Tetajn dhe për anëtarët e tjerë të Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit. Shndërrimi i shkollës fillore në Prapaqan në kazermë ushtarake ishte goxha i vështirë, sepse çdo gjë duhej bërë nga e para. Por, pavarësisht nga mungesa e mjeteve materiale, logjistike etj., me punë intensive kazerma dita-ditës e merrte formën e një qendre të mirëfilltë ushtarake duke u pajisur me inventar, kompjutera, me spital ushtarak dhe elementet tjera përcjellëse. Kazerma i kishte rreth gjashtëqind 600 shtretër, zyrë pune për eprorë, salla për leksione ushtarake etj. Siguria e kazermës brenda dhe jashtë ishte e sigurt nga pjesëtarët e UÇK-së. Çdo hyrje dhe dalje kontrollohej. Rampa ishte e vendosur në hyrje të Kazermës, e cila ishte ngjyrosur më ngjyrat kuqezi. Pesë ditë para ardhjes së grupit të oficerëve në Isniq, kishte ardhur

¹³ Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Shtabi Operativ i Rrafshit të Dukagjinit, N/O/D-14-05, Dukagjin, 8 korrik 1998; Kombet e Bashkuara, Lënda nr. IT-04-84bis-T, data: 29 nëntor 2012..., 35.

Sali Çekaj së bashku më pesë ushtarë në Kazermën e Prapaqanit, për të biseduar më anëtarët e SHORRD-së në lidhje me zhvillimet luftarake në terren dhe mundësinë e lokacionit për vendosjen e brigadave 131, 133 dhe 134 në Kazermën e Prapaqanit.¹⁴ Rustem Tetaj si kryeshef i Kazermës, e informoi në detaje Salih Çekajn për vështirësitë që kishte hasur gjatë asaj kohe në organizimin e ushtrisë dhe përgatitjen e kazermës. Pas bisedimeve shumë konstruktive të anëtarëve të SHORRD-së me konsensus morën vendim për vendosjen e brigadave në krye me Tahir Zemajn në Kazermën “Jusuf Gërvalla” në Prapaqan.¹⁵

Formimi i brigadave dhe bërthama e tyre u formuan në Voçidol dhe qendra tjera stërvitore në Shqipëri nga oficerë dhe ushtarakë të përgatitur. Përgjegjësit kryesorë të brigadave 131, 133 dhe 134 që përbënin strukturën komanduesi të brigadave ishin: Tahir Zemaj, Salih Çekaj, Agim Ramadani, Nazif Ramabaja, Kemajl Shaqiri, Lumni Surdulli, Ismet Ibishi, Rustem Berisha, Fadil Hadergjonaj, Bajram Stojkaj, Shaban Dragaj, Sefedin Kuçi, Musa Gjakova, Ismet Çekaj, Sebahate Tolaj, Zymer Lulaj, Esat Ademaj, Farush Thaqi etj. Para së të marshonin drejt Kosovës, ministri Ahmet Krasniqi, kishte emëruar edhe komandantët e brigadave. Tahir Zemaj u emërua komandant i Brigadës 134, Rustem Berisha u emërua komandant i Brigadës 131 dhe Kemajl Shaqiri u emërua komandant i Brigadës 133.¹⁶ Tahir Zemaj ishte oficeri me grada më të larta ushtarake dhe ishte emëruar komandant i tri brigadave.¹⁷ Ardhja e brigadave dhe inkuadrimi i tyre në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e mirëseardhur dhe një shtysë shumë e madhe në organizimin e luftës në Rrafshin e Dukagjinit.

Me vendosjen e ushtarëve të UÇK-së dhe oficerëve, kazerma e Prapaqanit e mori formën e saj të duhur. Flamuri kombëtar ngrihej çdo mëngjes sipas rregullave që kishte përcaktuar komanda e Kazermës. Në rrethana të jashtëzakonshme u caktuan detyrat e eprorëve për të organizuar dhe përgatitur sa më parë pjesëtarët e UÇK-së. Pjesa më e madhe e ushtarëve meqë ishin vullnetarë nuk kishin njohuri për artin ushtarak. Ushtrimet për përdorimin e armëve ishin njëra ndër pjesët thelbësore të trajnimit të ushtarëve në Kazermë. Disa nga komponentët kryesorë që duhet të trajnoheshin ushtarët e UÇK-së në kazermë gjatë asaj kohe përfshinin: 1.

¹⁴ Të gjitha përgatitjet për funksionalizimin e Kazermës “Jusuf Gërvalla” ishin bërë nga anëtarët e SHORRD-së. Grupi i oficerëve e kishin gjetur të gatshme me gjitha elementët e nevojshme për të jetuar dhe vepruar në rrethana të luftës.

¹⁵ Deklaratë e oficerit Rustem Tetaj, dhënë autorit më 5 dhjetor 2010.

¹⁶ Frashër Demaj, *Salih Çekaj, Veprimtaria politike dhe ushtarake*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2024, 310.

¹⁷ Kombet e Bashkuara, Lënda nr. IT-04-84bis-T, data: 29 nëntor 2012..., 110.

manovrat taktike - ushtarët mësonin si të pozicionoheshin në terren, duke marrë parasysh topografinë dhe kushtet e vështira në terren; 2. strategjitë e sulmit dhe mbrojtjes ndaj objektivave të ndryshme dhe mbrojtjen e pozitive nga sulmet e ushtrisë serbe, komunikimin dhe koordinimin efektiv për të arritur objektivat e përbashkëta, përdorimi i armëve të lehta deri tek ato të rënda, për të siguruar që çdo ushtar të ishte i aftë të operonte me sukses.

Këto aktivitete ishin të rëndësishme për ndërtimin e një force të organizuar dhe efikase, e cila ishte e gatshme të përballonte sfidat e luftës për çlirimin e Kosovës. Pas përgatitjeve dhe stërvitjeve brenda kazermës, ushtarët u angazhuan në operacione të ndryshme ushtarake në terren. Morën pjesë në shumë beteja ushtarake kundër ushtrisë serbe. Ushtarët ishin të trajnuar edhe në mbështetjen logjistike duke siguruar furnizime dhe mbështetje për njësitë që ishin në vijën e frontit. Kazerma si pikë e organizuar dhe e strukturuar mirë kishte rol të shumëfishtë në mbarëvajtjen e luftimeve në terren. Kazerma ofronte strehim, pushim dhe trajtim të shpejtë për ata që ishin në vijat e luftimeve. Kazerma ofronte mbështetje logjistike, ushqim dhe pajisje tjera të nevojshme për pjesëtarët e UÇK-së, si dhe mbështetje mjekësore për të trajtuar ushtarët e plagosur.

Brigadat e vendosura në kazermën e Prapaqanit morën pjesë në shumë beteja në Rrafshin e Dukagjinit. Njëra ndër betejat më të rëndësishme është beteja e Logjës që u zhvillua më datë 6 korrik 1998. Përveç njësiteve të rregullta të UÇK-së që vepronin në kuadër të Kazermës së Prapaqanit dhe Baranit, kontribut kanë dhënë edhe luftëtarët e fshatrave të Lugut të Baranit, Deçanit etj.¹⁸

Në “Kazermën e Prapaqanit” ishin ngritur dy strehimore për t’u mbrojtur në rast sulmi nga granatimet e artilerisë serbe. Për ndërtimin e tyre janë përkujdesur fshatarët në mënyrë vullnetare. Njëra prej tyre ishte parashikuar për strehim në rast të bombardimeve nga ushtria serbe e tjetra ishte parashikuar për vendosjen e spitalit ushtarak. Gjatë sulmit të dytë në betejën e Logjës njëra prej tyre ka shërbyer për spital. Kapacitetet e strehimoreve zënin rreth gjashtëqind (600) veta, të cilat ishin të pajisura edhe me kushte të nevojshme për të jetuar. Kazerma në Prapaqan ishte e pajisur edhe me qendrat stërvitore dhe me poligonin e qitjeve me armë. Poligoni i qitjeve ishte vendosur në fshatin Kotradiq për arsye sigurie dhe praktike.¹⁹

Po ashtu ishte e domosdoshme që të organizohej spitali ushtarak në kuadër të Kazermës. Shefe për çështje shëndetësore ishte emëruar Ryvë

¹⁸ Luan Tetaj, “Themelimi i Kazermës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës - Baran 1998”, Jasharajt dhe lufta çlirimtare..., 380.

¹⁹ Arbër Ahmetaj, Sefedin Krasniqi, *Kështu foli Tahir Zemaj I, një rrëfim për luftën*, Ribotim, “Dukagjini”, Pejë, 2019, 86-87.

Loshaj. Ishte bërë organizmi i qendrave mjekësore në Rrafshin e Dukagjinit, të cilat ishin furnizuar me ilaçe nga organizata të ndryshme. Kontribut të çmuar në shërimin e ushtarëve të plagosur kanë dhënë grupi i mjekëve: Avdyll Krasniqi, Ilir Tolaj, Time Kadrijaj, Sylë Bruqi, Din Krasniqi, Selmon Berisha, Arif Tahirsylaj, Smajl Avdimetaj dhe Shpëtim Robaj. Në kushte shumë të rënda grupi i mjekëve u organizua dhe arritën t’u dalin në ndihmë ushtarëve të plagosur dhe popullsisë në Zonën e Dukagjinit. Brenda Kazermës “Jusuf Gërvalla” kishte edhe të plagosur, të cilët shëroheshin në kuadër të spitalit ushtarak. Në mesin e tyre ishte edhe Naim Maloku emër i njohur i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në Kazermën ushtarake “Jusuf Gërvalla” në Prapaqan, përveç takimeve të rregullta mes eprorëve të zonave të ndryshme të Kosovës, u organizuan takime shumë të rëndësishme mes udhëheqësve të UÇK-së dhe misioneve diplomatike botërore. Përfaqësuesit e UÇK-së biseduan me atasheun ushtarak të misionit të OSBE-së me qendër në Pejë. Me ushtarakun gjerman Wolfgang Kaufmann, i cili drejtonte gjithë grupin e atasheve ushtarakë të vendeve anëtare të kësaj organizate.²⁰ Takimet e nivelit të tillë ishin të mirëseardhura për përfaqësuesit e UÇK-së, që t’u bënë njohur përfaqësuesve ndërkombëtarë dhe vendeve perëndimore se shqiptarët e Kosovës me luftën e saj ishin të vendosur për t’i fituar të drejtat e tyre që u takonin. Takimet e tilla shërbenin për të njoftuar faktorin ndërkombëtar se UÇK-ja është vërtet ushtri e organizuar që lufton për çlirimin e vendit.

Forcat ushtarake dhe policore serbe gjatë muajt gusht dhe shtator të vitit 1998 ndërmorën njërën ndër ofensivat më të fuqishme kundër pozicioneve të UÇK-së në Rrafshin e Dukagjinit që deri në atë kohë nuk ishte parë në Kosovë. Gjatë muajt gusht furnizimi me armatim i pjesëtarëve të UÇK-së ishte bërë shumë i vështirë për t’u siguruar përmes Shqipërisë, sepse ushtria serbe edhe ato pak korridore të fshehta që i përdorte UÇK-ja për futjen e armëve në Kosovë i kishte mbyllur. Ushtria serbe ishte e përgatitur për një ofensivë të madhe në Zonën e Dukagjinit. Në ofensivën ushtarake të ushtrisë serbe në Zonën e Dukagjinit kishin marr pjesë: dy brigada të inkuadruara drejtpërdrejt me rreth dy mijë (2 000) deri në tre mijë (3 000) ushtarë, dy batalione të motorizuara me rreth një mijë (1 000) mjete të luftës, ndërsa në Rrafshin e Dukagjinit mendohej se kanë vepruar rreth njëzet mijë (20 000) trupa të ushtrisë serbe.²¹

Në mungesë të theksuar të armëve, ishte pothuajse e pamundur për t’u përballuar me ofensivën serbe. Sulmet më të fuqishme të forcave serbe që i

²⁰ Po aty, 88.

²¹ Bardh Hamzaj, *Rrëfimi për luftën dhe lirinë (Dialog me komandantin Ramush Haradinajn)*..., 98.

kanë goditur pozicionet e UÇK-së kanë qenë nga Suka e Biteshit, Suka e Cërmjanit, Podi i Gështenjave etj. Pas një rezistence të fuqishme ushtria serbe arriti të thyente rezistencën e UÇK-së në Smolicë, Junik, Voksh, Baballoq, Dujakë, Gramaçel, Rastavicë, Perlep, Gllogjan, Irzniq, Shaptej, Carrabreg, Beleg etj. Po ashtu ushtria serbe kishte ndërmarr ofensivë edhe në drejtim të fshatrave të Dushkajës veçanërisht Jabllanicës dhe në drejtim të fshatrave të Lugut të Baranit të komunës së Pejës.²²

Si rrjedhojë e situatës tejet të rëndë në terren, rreth datës 20 gusht 1998, përfaqësuesit e fshatrave të Zonës Operative të Dukagjinit u mbledhën në takim në Kazermën e Prapaqanit për të diskutuar në lidhje me situatën e krijuar në terren dhe mundësin për t'u shmangur masakrave të mundshme të ushtrisë serbe.²³ Pas shumë diskutimeve përfaqësuesit e fshatrave votuan për ndërrimin e komandës në Zonën Operative të Dukagjinit duke shpresuar në përmirësimin e situatës në terren, por kjo gjë më vonë dëshmoi se situata në terren sa vinte dhe përshkallëzohej edhe më shumë. Më 21 gusht 1998, Ramush Haradinaj dhe Tahir Zemaj e miratuan së bashku vendimin ku pasqyrohej ndërrimi i komandës në ZOD. Komandant u emërua Tahir Zemaj, zëvendëskomandant Ramush Haradinaj, kryeshef i Shtabit Nazif Ramabaja, ndihmëskomandant për Zbulim dhe Kundërzbulim Ismet Ibishi, ndihmëskomandant për Moral Salih Çekaj, ndihmëskomandant për Informim Faton Mehmetaj, ndihmëskomandant për Sigurim Idriz Elezaj, ndihmës komandant për Logjistikë Rustem Tetaj dhe ndihmëskomandant për Mbrojtje Territoriale Shemsedin Çeku.²⁴

Si rrjedhojë e ndërrimit të komandës në ZOD u formua Drejtoria Operative e Rrafshit të Dukagjinit, për arsye të kontrollimit të katër brigadave. Tahir Zemaj shkoi edhe më tutje duke urdhëruar që të formohej Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në bazë të emërimeve të reja dhe të paraqiten kundërshtimet e mundshme brenda 24 orëve. Tri ditë pas ndërrimit të komandës në ZOD, më datën 23 gusht 1998, në Kazermën e Prapaqanit erdhi një delegacion i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në krye me Bislim Zyrabin, të cilët e kritikuan vendimin duke e deklaruar të shfuqizuar vendimin për ndërrimin e komandës në ZOD. Më datën 2 shtator 1998, oficerët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së u mbledhën në Zhebel të komunës së Gjakovës. Me këtë rast u theksua se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte marr vendim që komandant i UÇK-së për Zonën Operative të Dukagjinit të ishte Ramush Haradinaj.²⁵

²² Po aty.

²³ Kombet e Bashkuara, Lënda nr. IT-04-84bis-T, data: 29 nëntor 2012..., 42.

²⁴ Po aty, 43.

²⁵ Kombet e Bashkuara, Lënda nr. IT-04-84bis-T, data: 29 nëntor 2012..., 44.

Grupi i oficerëve që përfaqësonte Ministrinë e Mbrojtjes nuk arritën marrëveshje me përfaqësuesit e Shtabit të Përgjashëm të UÇK-së. Pas diskutimeve të gjata vendimi u shfuqizua dhe Ramush Haradinaj u riemërua komandant i ZOD-së.²⁶

Në fillim të shtatorit 1998 “Kazerma e Prapaqanit” ishte e rrethuar dhe rezistenca ushtarake ishte e pamundur. Popullsia e fshatrave të komunës së Deçanit, Gjakovës, Rekës së Keqe, Dushkajës, rajonit të Vokshit, Lugut të Baranit etj., që numëronin rreth tetëdhjetëmijë (80 000) njerëz u mbledhën në fshatin Isniq, në fusha të hapura për të shpëtuar nga masakrat e ushtrisë serbe. Në popull ishte krijuar një situatë shumë e paqartë, paniku kishte arritur kulmin më të lartë. Çdo ditë kishte zhvendosje të popullsisë nga një fshat në tjetrin. Gjendja humanitare e popullsisë ishte shumë e rëndë. Pjesa më e madhe e tyre ishte strehuar nëpër fusha, male, pa ushqim, pa ujë, të sëmurë, fëmijë, pleq, gra shtatzëna etj. Banorët e fshatit Isniq, brenda mundësive të tyre bënë të pamundurën për t’i strehuar banorët nëpër shtëpitë e tyre duke u përkujdesur për mirëqenien e tyre, por ishte e pamundur t’u vihej në ndihmë të gjithëve. Kazerma e Prapaqanit ishte shumë afër fshatit Isniq rreth dy kilometra dhe në rast të një rezistence ushtarake të njësiteve të UÇK-së, pasojat do të ishin shumë të mëdha për popullsinë që ishte mbledhur në fshatin Prapaqan, Dubovikë, Isniq etj. Çdo granatim i mundshëm në drejtim të kazermës mund të kishte viktima të shumta. Duke e analizuar situatën e rëndë në terren dhe për të shpëtuar popullsinë nga masakrat e mundshme nga ushtria serbe, njësitet e UÇK-së në krye me Tahir Zemaj që vepronin në Kazermën e Prapaqanit, morën vendim në koordinim me Qeverinë e Republikës së Kosovës që ushtria të tërhiqej në Bjeshkët e Nemuna, për të shpëtuar popullin nga masakrat e ushtrisë serbe. Më datën 8 shtator të vitit 1998 ushtria në krye me Tahir Zemajn ishte tërhequr nga Kazerma e Prapaqanit. Pas tërheqjes së ushtrisë në Bjeshkët e Nemuna në krye me Tahir Zemajn marshoi drejt kufirit në (trekëndëshin) Kosovë-Shqipëri-Mali i Zi. Por, ishte e vështirë për njësitet e UÇK-së për të thyer kufirin dhe për të hyrë në Shqipëri, për shkak të mbrojtjes së fortë nga forcat e ushtrisë serbe. Gjatë luftimeve për të thyer kufirin u vranë dy ushtarë të UÇK-së: Shpëtim Bobaj dhe Sadri Vishaj. Në përpjekje për të tërhequr trupat e tyre është vranë edhe Xhevat Musliaj.²⁷

Në tërheqje e sipër meqë nuk u arritë të kalohej kufiri, të njëjtit u detyruan të tërhiqeshin dhe marshuan në drejtim të Shtabit lokal të UÇK-së në Rugovë. Arritja deri në Rugovë ishte shumë sfiduese, sepse u deshën katër ditë rrugë për të arritur në destinacion. Gjendjen edhe më të vështirë e bënin

²⁶ Po aty, 44.

²⁷ Arbër Ahmetaj, Sefedin Krasniqi, *Kështu foli Tahir Zemaj*, një rrëfim për luftën, Mërgimi, 2002, Prishtinë, 2001, 103-104.

të plagosurit dhe popullsia civile që iu kishte bashkëngjitur kolonës së UÇK-së. Pjesa më e madhe popullsisë civile, pleq, gra, fëmijë dhe një pjesë e vogël e ushtarëve kishin marshuar në drejtim të Plavës për të kaluar pastaj në Shqipëri. Edhe pas tërheqjes së Tahir Zemajt nga Rugova dhe pjesës më të madhe të ushtarëve të UÇK-së, eprori Rustem Tetaj, kishte vazhduar të qëndronte në Rugovë. Ai fillimisht ishte vendosur në shtëpinë e Smajl Lajçit ku kishte qëndruar tri ditë dhe pastaj kishte lëvizur për në fshatin Stankaj në familjen e Mustaf (Halil) Shpendit. Kjo familje i ka mirëpritur dhe është përkujdesur për pjesëtarët e UÇK-së, me gjëra ushqimore dhe me medikamente shëndetësore. Njësitet e UÇK-së në krye me eprorin Rustem Tetaj, ishin të armatosur dhe të përgatitur për të luftuar kundër ushtrisë serbe të ardhur nga territori i Malit të Zi. Por, ushtria serbe gjatë gjithë kohës e vëzhgonte kufirin, pa u hedhur në luftime ushtarake kundër njësiteve të UÇK-së. Gjatë qëndrimit në Rugovë gjendja shëndetësore e eprorit Rustem Tetaj ishte përkeqësuar dhe urgjentisht kërkohej trajtim i specializuar mjekësor. Për këtë arsye ai u dërgua në Shqipëri ku u vazhdua trajtimi i mëtejshëm shëndetësor.²⁸

Pas tërheqjes në Bjeshkët e Nemuna, forcat e ushtrisë serbe nuk vonuan shumë dhe u futën në fshatin Isniq. Paraprakisht ushtria serbe kishin dërguar tri (3) ultimatume Shtabit Lokal në Isniq për t'u tërhequr. Pas analizimit të tri ultimatumeve dhe frika rreth një masakre mbi popullsinë civile që ishin strehuar në fshatin Isniq, udhëheqësit e Shtabit marrin vendim që të tërhiqeshin forcat e tyre nga pozicionet luftarake që deri në këtë kohë vazhdonin të mbanin në Isniq. Për të shpëtuar popullsinë civile nga masakrat e mundshme të forcave serbe, Shtabi i Isniqit u detyrua të tërhiqej nga pozicionet dhe qëndrimet e tyre. Pas vendimit të Shtabit lokal në Isniq, popullsia filloi të tërhiqej nga fshati dhe në këtë mënyrë u arrit që të shpëtohet popullsia civile.

Edhe pas tërheqjes së një pjese të efektivit ushtarak në Bjeshkët e Nemuna, luftëtarët e UÇK-së në krye me Ramush Haradinajn vazhduan të qëndrojnë dhe të veprojnë brenda mundësive të tyre në Zonën Operative të

²⁸ Republika e Kosovës, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nxjerri vendimin sekret ushtarak zyrtar, me nr. portokalli 01/73 dt. 19.12.1998, Tiranë. Vendimi për lejimin e shërimit, duke u bazuar nga gjendja shëndetësore e eprorit Rustem Tetaj dhe në bazë të fakteve relevante nga ana mjekësore si dhe mendimit të dr. Arsim Qavdarbasha, biem në këtë vendim: 1. Që eprori Rustem Tetaj t'i lejohet shërimi-operacioni mjekësor nga sëmundja siç shihet në dokumentacionin për intervenime kirurgjike. 2. Operacioni i lejohet të kryhet në shtetit e Turqisë për shkaqe të mundësive që janë të krijuara edhe për raste të tjera të mëparshme në këtë shtet. 3. Për të dhëna më të sakta i drejtohet shërbimit sanitar të Shtabit të Përgjithshëm, i cili obligohet t'i kryej të gjitha aktivitetet në lidhje me rastin konkret.

Dukagjinit. Për shkak të ofensivës së madhe serbe, u nevojit shumë kohë për t'u riorganizuar meqë goditja ishte shumë e rëndë.

Kazerma e Prapaqanit e themeluar në rrethana të rënda të luftës në komunën e Deçanit, kishte rendësi të madhe në sensibilizimin dhe zhvillimin e luftës çlirimtare jo vetëm në Rrafshin e Dukagjinit, por edhe më gjerë. Ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Kazermën “Jusuf Gërvalla” në Prapaqan morën leksionet e para rreth artit ushtarak nga oficerët shqiptarë të Kosovës, duke i kontribuar kështu edhe masivizimit dhe sensibilizimit të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kazerma ishte një shembull unik në Kosovë, sepse, duke u referuar kuadrit profesional dhe punës së tyre, arritën që me mijëra ushtarë të UÇK-së të aftësohen mjaftueshëm për të vazhduar luftën për çlirimin e vendit. Po ashtu, kjo kazerma shërbeu si një qendër stërvitore dhe edukative, ku ushtarët përvetësuan njohuri të rëndësishme taktike dhe strategjike, që do t'i shërbenin më pas në fushat e betejave për çlirim. Stërvitjet intensive dhe përkushtimi i oficerëve të UÇK-së bëri që Kazermën “Jusuf Gërvalla” ta konsideronin si një shkollë e vërtetë e luftës, e cila shënoi një hap të rëndësishëm në ngritjen e aftësive luftarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Zonën Operative të Dukagjinit.

Luan TETAJ

SUMMARY

THE FOUNDATION OF THE BARRACKS “JUSUF GËRVALLA” IN PRAPAQAN AND THE SITUATION IN DUKAGJIN IN 1998

The establishment of the “Jusuf Gërvalla” Barracks in Prapaqan in 1998 was of great importance in raising awareness and organizing the liberation war, not only in the municipality of Deçan but also beyond. Organising the barracks in wartime circumstances was a complex and challenging process. The barracks had a well-organized structure to withstand attacks from the Serbian army in the Dukagjin Plain. The KLA units within the barracks were trained in their daily operations.

The barracks was unique in its kind because, for the first time in Kosovo’s history, military lectures were held in the Albanian language, which served as an additional motivation for recruiting young people into the ranks of the Kosovo Liberation Army. This allowed KLA soldiers to learn and understand the military art better. The barracks served as a base for training KLA soldiers, and an operational centre that helped coordinate combat activities in the Operational Zone in the Dukagjini Plain.